

PËRSIATJET SHPIRTËRORE NË POEZINË E NAIM FRASHËRIT

Libri që shënon fazën e parë të krijimtarisë së poetit kombëtar shqiptar Naim Frashëri, është vëllimi poetik i shkruar në persisht me titullin “Tehajjulat”. Ky libër u botua në Stamboll në vitin 1884 dhe rreth një shekull më vonë u përkthye mjeshtërisht në gjuhën shqipe nga orientologu Vexhi Buharaja.

Libri “Tehajjulat”, ose siç ka ardhur në shqip me titullin “Ëndërrimet”, është vepra që ka ndriçuar prirjet shpirtërore të Naim Frashërit, sepse secila poezi është ngjizur ose me një lëndë moralistike, ose mbi bazën e misticizmit, ose mbi të vërtetën e krijimit të botës e të jetës, ku të gjitha kanë një bosht të përbashkët, i cili është qëllimi për ta çuar njeriun drejt përsosmërisë së plotë.

Ndryshe nga praktikat krijuese të përbotshme, shembulli i Naim Frashërit është tejet i veçantë, sepse rrallëherë ndodh njësimi, apo barazimi mes autorit dhe heroit lirik. Ekzistenca e këtij njësimi dëshmohet me faktin se vetëm një njeri i madh moralisht, mund të bëjë vepra të mëdha në dobi të njerëzimit. I tillë ishte edhe Naim Frashëri, një njeri që tejkaloi fatkeqësitë individuale (vuajtjen nga sëmundja e tuberkulozit dhe vdekjen e njerëzve të tij më të dashur, si e bija, motra, vëllai etj.) dhe përqafoi një botëkuptim më të gjerë, pikërisht përhapjen e mesazheve shpresëdhënëse e paqësore. Edhe pse me shpirt të helmuar nga sprovat e jetës personale, ai arriti që në poezi të paraqesë virtytet më fisnike shpirtërore dhe elementet që duhet të drejtojnë jetën e çdo qenieje njerëzore. Ky qëndrim i tij në jetë dhe në letërsi ishte produkt i formimit kulturor e shpirtëror që kishte marrë, veçanërisht prej qytetërimit islam dhe autorëve persianë, si Rumi, Saadiu etj. Ndikimi prej këtyre autorëve është kaq i madh, sa që shumë punime shkencore rreth krijimtarisë naimjane janë fokusuar pikërisht në metodën krahasuese mes poetit tonë dhe poetëve të ndryshëm persianë, ku padyshim janë

gjetur shumë pikëtakime.²⁹⁶*

Në dritën e këtij arsyetimi, prof. Eqrem Çabej i konsideronte disa vepra të Naim Frashërit si fis me botën orientale²⁹⁷. Që Naim Frashëri përshkonte me lehtësi hapësirat e poezisë orientale, këtë e dëshmon fare mirë vëllimi i tij *“Tehajjulat”*, ku autori ka mundur të përcjellë pjesë nga figuracioni dhe fjalori i poezisë lindore, duke i veshur me tisin e personalitetit të tij krijues. Në këtë buqetë me lirika, të stolitur me stilin e miniaturave liriko-filozofike, dëshmohet ndikimi i autorit prej kulturës lindore, sepse përdoret simbolika e burimit kuranor për të paraqitur botën shpirtërore të njeriut.

Para syve të një panteisti të vërtetë, siç është Naim Frashëri, spiritualizmi dhe materializmi janë si dy pasqyra me ngjyra të ndryshme në dukje, por që në esencë shërbejnë për reflektimin e jetës e të natyrës, të cilat burojnë prej një uniteti absolut. Gjithësia konsiderohet si shkolla e shfaqjes së këtij uniteti. Ndërsa organi me të cilin njeriu e njeh praninë e këtij uniteti absolut nuk është mendja, por është zemra.

Në vargjet e poezisë *“Gjuha e zezrës”* dëshmohet se mjeti dhe mënyra për t’iu afruar Zotit është vetëm dashuria ndaj tij:

Prandaj zezrës kjo gjuh’ i është dhënë,

që t’i thotë asaj të fshehtën e pathënë.

Këtë gjuhë e dëgjojnë dijetarët,

rrugënjohësit e dijes, zbulimtarët.

(Poezia *“Gjuha e zezrës”*, f. 21)

Që në titullin e poezisë shënjohej *“gjuha”* si organi bazë i ndijimit organik të shijes, si dhe i artikulimit të tingujve, që përcjellin mendimet e njeriut. Gjuha paraqitet e bashkuar me zemrën, që është organi qendror i sistemit të qarkullimit të gjakut, por edhe vatra simbolike e ndjesive të ndryshme njerëzore.

Sintagma *“gjuha e zezrës”* njëson në një hulli të vetme perceptimin, ndijimin dhe mendimin, për shkak se përcillet ideja se vetëm njeriu i ditur është në gjendje të zotërojë njohjen përmes zezrës. *“Naim Frashëri e shquan njohjen me anën e*

²⁹⁶ *Mbi ndikimet e kulturës lindore në krijimtarinë e Naim Frashërit, vlen të veçohet punimi i studiuesit Jorgo Bulo, *“Tipologjia e lirikës së Naim Frashërit”*, Tiranë, 1999.

²⁹⁷ Çabej, Eqrem. *“Shqiptarët midis perëndimit dhe lindjes”*, Tiranë, 1994, f. 11.

zembrës, sidomos kur përsiat për Zotin. Ai shfaq dyshimin në mundësinë e njohjes racionale të natyrës, jo pse nuk e pranon mundësinë e mendjes për të njohur botën sendësore, por sepse e përjashton mundësinë e njohjes racionale të Zotit. Sipas tij, nëse Zotin nuk mund ta njohim me mendje, mund ta ndjejmë dhe ta përvetësojmë me ndjenja.^{298]} Epërsia e rolit njohës të zembrës në raport me mendjen shpjegohet për dy arsye:

Së pari, Zoti është një qenie hyjnore, të cilin mendja njerëzore nuk është në gjendje që ta rrokë konkretisht, sepse ai nuk ka të ngjarë me asnjë nga krijesat e veta të universit. Kjo dëshmohet edhe në Kuranin e Madhërishëm, ku Zoti përshkruhet si ‘drita e qiejve dhe e tokës’, që nuk mund të shihet me anë të syrit e të trupit. Ai është i dukshëm vetëm me vështrimin e brendshëm të zembrës. Ndërsa “shfaqja e zembrës” përcaktohet si “tejvështrimi me zemër në dritën e sigurisë, e cila fshihet në botën e padukshme”. Drita e sigurisë intuitive, me të cilën zemra sheh Zotin, është një rreze po e kësaj drite hyjnore, që lëshohet prej Krijuesit në zembrën e njeriut, sepse, nëse nuk do të funksiononte kështu, nuk do të ishte i mundshëm asnjë vizion i Tij.^{299]} Njeriu ndien praninë e tij kudo me zemër dhe më pas, me mendje arsyeton mbi porosinë hyjnore: *Në çdo vend që hedh njeriu të zbehtin sy,/ Dritn’ e Zotit të vërtetë sheh aty,/ Plotfuqi pa shëmbëllim e pa kufi.*

Së dyti, shpirti është i pavdekshëm për poetin, ndryshe nga trupi që është i përkohshëm e doemos pjesë e trupit është edhe mendja. Sipas kësaj filozofie, lidhja dhe dashuria për Krijuesin është e pandërprerë në kohë dhe në hapësirë, sepse shpirti njerëzor është i përjetshëm.

Koncepti i përjetësisë së shpirtit shënjohej edhe përmes komunikimit me botën e përtejme, kur heroji lirik këndon mbi varrin e motrës së vdekur, me fjalët: *krahë shpirti...i lip vdekjes pa pushim,/ Që të vij te ti, moj motër, fluturim,/Që të t’gjej në qiell të lumtur e të qetë/ Në mes të dritës, pranë Zotit të vërtetë^{300]}.*

²⁹⁸ Qosja, Rexhep. “Historia e letërsisë shqipe”, vëllimi III, ShB TOENA, Tiranë, 2000, f. 223.

²⁹⁹ Nicholson, Reynold. “The Mystics of Islam”, Word Wisdom Inc., Canada, 2002, p. 68.

³⁰⁰ Poezia “Mbi varrin e sime motër”, “Ëndërrimet”, Rumi-Tetovë, 1996, f. 61

Sipas autorit, mënyra për të shkuar në botën e përtejme janë “krahët e shpirtit”, krahë të cilët shestojnë të bëhen pjesë e hapësirës së dritës pranë Zotit. Kjo dëshirë që i lypet vdekjes pa pushim, nxjerr në pah edhe konceptin e përshkallëzimit të materies, ku njerëzit diferencohen në bazë të veprave të tyre dhe devotshmërisë ndaj Zotit. Kështu, përdorimi i foljes “lip” mbart jo vetëm dëshirën e heroit lirik për të takuar motrën e vdekur në botën e përtejme, por edhe dëshirën e tij për të qenë pranë Krijuesit, pikërisht në xhenet.

Gjithashtu, ripërtëritja e shpirtit pas vdekjes përcillet në mënyrë metaforike me ripërtëritjen e stinëve, bimëve dhe natyrës në përgjithësi. Edhe pse bimët vyshken e kalben, ato ripërtërihen sërish në pranverë:

Këta drurë që të plakur duken sot,
Çdo pranverë mbushen flet’e kokrra plot.

(“Zemra e pikëlluar dhe e brengosur”, f. 62)

Në këto vargje theksohet përkohshmëria e të gjitha qenieve të universit dhe pamundësia për të prekur amshueshmërinë. Pavarësisht se lulet vyshken dhe drurët thahen, pra e përfundojnë ciklin e tyre jetësor, sërish ato përsëriten me elemente të llojit të vet, që do të thotë se lënda mbetet.

Kjo ide zgjerohet më tej në poezinë “Qielli”, ku autori deklaron: *Çdo gjë vdirot veç fytyrës së Atij!*³⁰¹ Pra, nëse çdo krijesë e gjithësisë e ka një fund, Krijuesi i Madhërisëm është i pafundmë dhe i pakohë. Në këto vargje demonstron edhe koncepti i emanacionit, që mbështet teorinë se bota rrjedh domosdoshmërisht nga Zoti dhe se ajo është krijuar me urdhrin e Zotit.

Ndjenja dhe shpirti ekzistojnë në çdo qelizë të vargjeve naimjane, si në pikëpamjen formale, në aliteracionin dhe muzikalitetin e ëmbël e ritmik të vargëzimit, ashtu edhe në pikëpamjen përmbajtësore; në shpirtëzimin e elementeve të natyrës, elemente të cilat herë marrin trajta njerëzore; si një vashë është bërë kjo natyra / ta josh shpirtin me stolitë ngjyra-ngjyra; e herë bëhen dëshmitarë të ndodhive të jetës së njerëzve, siç tregohet në poezinë “Hëna”: Ti ke parë gjithë ndodhitë e kësaj bote / Gjithë punë

³⁰¹ Poezia “Qielli”, “Ëndërrimet”, Rumi-Tetovë, 1996, f. 17

dhe çuditë e kësaj Rrote³⁰².

Përveç dimensionit filozofik të shpirtit, thelbi i të cilit gjendet pikërisht te Krijuesi i gjithësisë, ku prej tij marrin jetë e formë të gjitha qeniet, te Naim Frashëri shfaqet edhe dimension i praktik i shpirtit, ku autori rreket të shpalosë përbërësit që i japin qetësi e dobishmëri shpirtit të njeriut. Kjo frymë poetike i ka çuar shumë studiues shqiptarë në përkufizimin e poezisë së Naim Frashërit si poezi moralistike.

Në vargjet e poezisë “Zoti”, autori thekson se mirësia është e vetmja mbrojtje që e ruan njeriun nga plagët shpirtërore dhe me anë të mirësisë njeriu mund të arrijë fitoren më të vështirë: atë mbi vetveten. Nëse njeriu nuk u bën ballë fatkeqësive që i bien mbi krye, atëherë ai do të jetë i paaftë dhe i rrëmbyeshëm për të përmbushur një qëllim të caktuar, apo për të bërë një vepër të mirë. Liria e vërtetë e njeriut është kur ai është i zoti të kontrollojë vetveten. Njeriu që nuk mund t’u vërë fre pasioneve e dëshirave të këqija, nuk është i matur as në veprime, as në biseda, ai është një skllav i vërtetë. Ne duhet të zhdukim prej vetes sonë ligësinë, mërinë dhe zemërimin, sepse këto janë armiqtë më të këqij:

Ndaj hiq dorë o njeri prej ligësisë!

Nga e drejta rrugë kurrë mos u ndaj,

Të mos thuash:Ç’bëra unë, ah, pastaj.

Pastrimi i shpirtit prej ligësisë është edhe mënyra për t’u afruar me Zotin, sepse autori këshillon:

Dlire shpirtin, o ti miku besëdelirë,

Që kështu të gjesh pastaj të Zotit hirë!

Ndrite zemrën, mbaje larg nga ligësitë

Që të bjerë tek ajo e madhja dritë!...

Ne nuk mund të kemi mirësi në shpirt, nëse urrejmë, nëse mbajmë mëri, apo nëse u dëshirojmë të keqen të tjerëve. Shpirti që nuk është i pastër, nuk mund të arrijë dritën e amshueshme, prandaj Naimi thekson se dashuria për njeriun është një ndjesi që të jep qetësi e stabilitet në këtë jetë dhe në tjetrën. Ai në shumë vargje të vëllimit “Tehajjulat” veçon porosinë profetike islame: Dëshiroji vëllait tënd, atë që ti i dëshiron vetes sate!

Mëshira, dhembshuria, dashuria, shpresa dhe përballimi i

³⁰² Poezia “Hëna”, “Ëndërrimet”, Rumi-Tetovë, 1996, f.31

sprovave të jetës me kurajë e qetësi janë çelësi i harmonisë dhe i jetës së lumtur. Porosia e Naimit është:

Bëhu shok e mik me gjithë njerëzinë!

Mërgo shtypjen, ligësinë dhe mërinë!

Në çdo shpirt njerëzor duhet të qëndrojë e ndezur një dritë që ndriçon të gjitha hallet e mjerimet dhe kjo është pikërisht shpresa me besimin tek Allahu.

Dozat e moralit në poezitë e Naim Frashërit janë të natyrës praktike dhe e bëjnë lexuesin të kuptojë se kushti themelor që e lartëson shpirtin e njeriut është morali njerëzor, ndërsa pasuria më e çmuar është dituria. “Dija nuk e lë njeriun të bjerë në varfëri, sepse vetëm njeriu i ditur, mund të jetë njeri i përsosur moralisht. (...) Sipas konceptit të poetit, njeriu e sheh botën me sy, e vlerëson me shpirt dhe e ndien me zemër. Sytë e njerëzve do të shohin mirë, shpirti do të vlerësojë drejt, kurse zemra do të ndiejë pastër, në qoftë se janë njerëz të ditur.”³⁰³

Pra, epiqendër e botëkuptimit të autorit është fakti se dituria, çlirimi prej veseve të këqija, mëshira ndaj të dobëtisë dhe dashuria për të tjerët janë themelet që ndërtojnë shpirtin e njeriut, duke e bërë atë të pavdekshëm. Këto ide janë mbizotëruese jo vetëm në poezitë, por edhe në prozën e Naim Frashërit, megjithatë vëllimi poetik “Tehajulat” është një vepër ku ndodh shpërthimi botëkuptimor i autorit rreth shpirtit të njeriut.

³⁰³ Qosja, Rexhep. “Historia e Letërsisë Shqipe (Romantizmi-III)”, Toena, Tiranë, 2000, f. 186